



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:909283  
Datë: 15.12.2021  
Numri i dokumentit: 02512206

**Ac.nr.1002/18**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Enes Mehmeti kryetar, Lumni Sallauka dhe Arsim Hamzaj anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në kundër të paditurit A.H. nga fshati ... komuna e Ferizajt, për rimbursim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.791/15 datë 27.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.12.2021, ka marrë këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pathemeltë** ankesa e të paditurit A.H. nga fshati ... komuna e Ferizajt, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.791/15 datë 27.11.2017, **VËRTETOHET.**

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

**“I. APROVOHET** në tërsi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë,

**II. DETYROHET** i padituri A.H. nga fshat ..., Komuna Ferizaj , që paditëses t’ia paguan shumën prej 711.00€ ( shtatëqindnjëmbëdhjetëeuro) në emër të rimbursimit të pagesës të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2012 nga i padituri , me kamatën e cila do të llogaritet sipas lartësisë që e aplikojnë banakat për deponimet e rëndomta për shumat që qytetarët i afatizojnë për periudhë njëvjeçare nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare , shpenzimet e kësaj procedure në shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh , pas plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi , nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

**III.OBLIGOHET** *paditësja që të paguaj taksën gjyqësore për padi në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi , nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.*”

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të: *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore*, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e të paditurit ndërsa aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**- Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve ka ushtruar padi kundër të paditurit A.H. , për rimbursim të pagesës në emër të dëmit të paguar nga paditësja për personin e tretë.

Pretendimet si në padi paditësja i mbështet në rrethanat se i padituri me datë 28.04.2012 në ora 16.00 ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit rrugor ashtu që me automjetin e tij Daimler 124 e tij me targa ..., ka goditur automjetin tjetër që drejtonte E.K. duke i shkaktuar lëndime trupore, për çka paditësja është detyruar ta kompensoj personin e tretë E.K. në shumë prej 711.00€.

Paditësja pretendon se i padituri ka përgjegjësinë për kthimin e kësaj shume mbi bazën e nenit 12 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësinë, duke qenë se i padituri ka drejtuar automjetin e tij pa mbulesë sigurimi- me policë sigurimi të skaduar dhe se duke qenë se paditësja dëmet e shkaktuara nga i padituri i ka kompensuar personit të dëmtuar E.K atëherë i padituri ka detyrimin e kthimit të kësaj shume në emër të regresimit të dëmit të paguar nga paditësja, për fajin dhe përgjegjësinë e të paditurit.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë se paditësit, pas mbajtjes se seancës për shqyrtim kryesor ka marrë aktgjykimin e atakuar dhe nga provat e administruara ka vërtetuar gjendjen faktike sipas të cilës ka vërtetuar se ekziston detyrimi i të paditurit për kompensimin e shumës së kërkuar nga paditësja dhe se baza juridike nuk ishte kontestues në këtë rast, por i padituri pretendon në faktin se në rastin konkret ka ekzistuar ndarja e përgjegjësisë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),( j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë, dhe se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të

drejtë duke i nënvënë drejtë situatën e përcaktuar ligjore gjendjes faktike të vërtetuar nga i gjithë procesi gjyqësor në shkallë të parë, rregullisht.

Përkitazi me pretendimet e ankuesit për shkelje, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, duke i provuar kështu të gjitha faktet vendimtare të çështjes me çka ka krijuar një figurë të qartë të gjendjes faktike nga e cila pastaj në përputhje me normat e të drejtës materiale ka nxjerrë përfundimin për themelësinë e kërkesëpadisë.

Kolegji i kësaj gjykate duke vlerësuar ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar në dritën e gjendjes së fakteve dhe provave të çështjes ka gjetur se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i rregullt dhe i ligjshëm, dhe se mbështet në saktësinë e premisë së poshtme të silogjizmit gjyqësor që ka rezultuar i formësuar drejtë dhe plotësisht nga ku edhe është mbuluar drejtë gjendja e tillë faktike me atë juridike duke bërë vlerësimin e saktë dhe profesional përkitazi me ligjshmërinë e arsyeve mbi të cilat mbështet Aktgjykimi i atakuar në korelacion me ligjin për sigurimin e detyrueshëm të autorpërgjegjesisë.

Kolegji vlerësoi pretendimet lidhur me saktësinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar sa i përket lartësisë së shumës së gjykuar nga shkalla e parë dhe gjeti se e njëjta ka vendosur drejtë edhe përkitazi me lartësinë e shumës objekt kontesti duke qenë se nga provat e çështjes rezulton se paditësja ka kompensuar personin e tretë në shumën prej 711.00€, dhe se pretendimet e të paditurit se gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerësoj rrethanat lidhur me kontributin eventual të personit të tretë E.K. në shkaktimin e aksidentit të datës 28.04.2012, kolegji i ka vlerësuar të paqëndrueshme ngase nga shkresat e lëndës vërtetohet se i dëmtuari E.K. është kompensuar nga paditësja BKS-ja duke vlerësuar kontributin e tij në shkallën prej 20% të përgjegjesisë së tij, për çka e njëjta me rastin e kompensimit Atij i ka përlllogaritur gjegjësisht zbritur pjesën e kontributit prej 20%, me rastin e kompenimit- pagesës së shumës kompenzuese.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.1002/18 me datë 07.12.2021**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari**  
Enes Mehmeti